

PROCESVERBAL
nga seanca e katërbëdhjetë e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 19.10.2025

Anëtarët e Këshillit të Agjencisë të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Sasho Stefanovski, mr. Zirjeta Jajaga, Gordana Majnova, Afrona Vërzivolli, Cvetanka Minovska, Petar Xhurovski, Viktor Pavlovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajčevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Punonjësit nga shërbimi profesional të pranishëm nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, mr. Emilija Janevska, Cvetanka Mitrevska, Maja Damevska, dr. Ivana Stojanovska, Sergej Todorovski.

Të pranishmit e tjerë: /

Kryetari i Këshillit, mr. Sasho Stefanovski, hapi seancën e katërbëdhjetë të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 13:00 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi si vijon:

RENDIN E DITËS

1. Propozime për iniciimin e procedurës kundërvajtëse për shkelje të heshtjes zgjedhore – Zgjedhjet Lokale 2025.
2. Të ndryshme.

Pika 1

Z. Trajčevski shpjegoi Propozimet për iniciimin e procedurës kundërvajtëse për shkelje të heshtjes zgjedhore gjatë kohës së Zgjedhjeve Lokale 2025. Lidhur me shkeljen e parë, ai theksoi se gjatë kryerjes së mbikëqyrjes mediatike më 18 tetor 2025, tek transmetuesi SHTR Kompani 21-M SHPKNJP Shkup, i cili transmeton programe në nivel shtetëror, është konstatuar shkelje e nenit 76-b paragrafi 3, në lidhje me nenin 69-a paragrafi 2 të Kodit Zgjedhor. Konkretisht, në datën e deklaruar, gjatë kohës së heshtjes zgjedhore në rrethin e parë të Zgjedhjeve Lokale 2025, radiodifuzeri ka emetuar reprizë të emisionit të veçantë informativ "Klik plus - debat zgjedhor", i cili u shfaq premierë më 17 tetor 2025. Në emision marrin pjesë tre kandidatë për kryetar të komunës Qendër, që paraqet shkelje të heshtjes

zgjedhore. Për këtë shkak, propozohet që Këshilli të miratojë konkluzion për iniciimin e procedurës kundërvajtjeje para gjykatës kompetente kundër SHTR Kompani 21-M SHPKNJP Shkup.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer (monitorim) të prezantimit mediatik zgjedhor, nr.10-4431/1 datë 18.10.2025 të SHTR Kompani 21-M SHPKNJP Shkup dhe për shkak të shkeljes së nenit 76-b paragrafi 3 të Kodit Zgjedhor njëzëri konkludoi iniciimin e procedurës kundërvajtjeje para gjykatës kompetente kundër SHTR Kompani 21-M SHPKNJP Shkup.

Në kundërshtim me nenin 76-b paragrafi 3, dhe në lidhje me nenin 69-a paragrafi 2 të Kodit Zgjedhor, SHTR Kompani 21-M SHPKNJP Shkup, më 18 tetor 2025, gjatë heshtjes zgjedhore për rrethin e parë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, ka ritransmetuar reprizë të programit të veçantë informativ Klik plus-debate zgjedhore, transmetuar premierë më 17.10.2025, realizuar si debat në të cilin marrin pjesë tre kandidatë për kryetar të Komunës Qendër, përkatësisht transmetoi informacione dhe materiale audiovizuele në të cilin marrin pjesë pjesëmarrësit në zgjedhje.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë kërkesë për iniciimin e procedurës kundërvajtjeje para gjykatës kompetente kundër Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup.

Drejtori Trajčevski, në lidhje me propozimin për iniciimin e procedurës kundërvajtjeje për shkak të shkeljes së heshtjes zgjedhore gjatë Zgjedhjeve Lokale 2025, informoi për shkeljen e Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV Shutel SHPKNJP Shkup. Ky radiodifuzer transmeton program në nivel rajonal, në territorin e qytetit të Shkupit. Nga monitorimi është përcaktuar se më 18 dhe 19 tetor 2025, radiodifuzeri ka shkelur nenin 76-b paragrafi 3 të Kodit Zgjedhor, përkatësisht shkeli dispozitat që lidhen me ndalimin për prezantim mediatik zgjedhor gjatë heshtjes zgjedhore. Njëkohësisht, në datat e përmendura, është transmetuar spot muzikor kushtuar ish-deputetit dhe kryetarit të partisë "Lidhja e Romëve të Maqedonisë", Amdi Bajram. Në videoklip shfaqet djali i tij, Elvis Bajram, i cili është kandidati aktual për kryetar të komunës së Shuto Orizarës nga e njëjta parti politike, si dhe ish-kryetar i së njëjtës komunë. Bazuar në shkeljen e konstatuar, propozohet që Këshilli të miratojë konkluzion për iniciimin e procedurës kundërvajtjeje para gjykatës kompetente kundër TV Shutel SHPKNJP Shkup.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer (monitorim) të prezantimit mediatik zgjedhor, nr.10-4434/1 datë 19.10.2025 të Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV Shutel SHPKNJP Shkup dhe për shkelje të nenit 76-b paragrafi 3 të Kodit Zgjedhor dhe njëzëri konkludoi iniciimin e procedurës kundërvajtjeje para gjykatës kompetente kundër Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV Shutel SHPKNJP Shkup.

Në kundërshtim me nenin 76-b paragrafi 3, dhe në lidhje me nenin 69-a paragrafi 2 të Kodit Zgjedhor, Shoqëria Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV Shutel SHPK NJPShkup, më 18 dhe 19 tetor 2025, gjatë heshtjes zgjedhore për rrethin e parë të fushatës zgjedhore për Zgjedhjet Lokale 2025, transmetoi informacione dhe materiale audiovizuele në të cilën marrin pjesë pjesëmarrës në zgjedhje, përkatësisht transmetoi spot muzikor dhe emision dokumentar ku paraqitet Elvis Bajrami, kandidat për kryetar të Komunës Shuto Orizarë nga bartësi i listës, Lidhja e Romëve të Maqedonisë.

Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë kërkesë për inicimin e procedurës kundërvajtëse para gjykatës kompetente kundër Shoqërisë Tregtare për Veprimtari Radiodifuzive TV Shutel SHPKNJP Shkup.

Pika 2

Të ndryshme

Nuk kishte diskutim nën "Të ndryshme".

Përktheu: Antoneta Shabani

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Mr. Sasho Stefanovski**